



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 349/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Muhamet Rexha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovë (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHEN ankesat si të bazuar.

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

PZAP ka pranuar dy ankesa më datë 07.12.2010, nga Lëvizja Vetëvendosja, në të cilën theksohet se me 06 dhjetor 2010 në ora 20:30 dhe me 07 dhjetor në ora 11:30 në rrugën Agim Ramadani në Prishtinë anëtarët e subjekti politik LDK kanë vendosur posterin e kandidatit për deputet Hashim Dëshishku mbi posterat e Lëvizjes Vetëvendosje, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Hashim Dëshishku, nga radhët e subjektit politik LDK, që është vendosur mbi posterin e Lëvizjes Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 08.12.2010, për ankesat që janë bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 09.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, më datë 09.12.2010, pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se: ankesat me nr 349/2 dhe ankesa me nr 351/2 janë të njëjta dhe kanë të bëjnë me të njëjtin poster dhe me të njëjtin vend, si dhe vendosjen e posterave në fjalë nuk e kanë bërë kandidatët e këtij subjekti politik, nuk është sqaruar qartë nga kush është bërë pasi që edhe për LDK është e panjohur nga kush është bërë, andaj ankesa, konsiderohet si e pabazë.

Përgjigjes në ankesë subjekti politik LDK nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Prandaj pasi që kemi të bëjmë me dy raste të njëjta PZAP-i vendosi si në vijim:

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, Neni 6.3 (Vendimet për ankesat) parasheh si vijon:

6.3 Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim- marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë.

Veprimet e Ndalura të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Neni 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërrës si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

PZAP-i vlerëson se subjekti politik LDK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa

A nr. 349,/2010 më datën 10.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

